

VENDIM
Nr. 67, datë 3.3.2023

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 257, DATË 21.12.2021 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA’ SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.3.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 120/4 prot., datë 1.3.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 257 datë 21.12.2021 “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Albanian Energy Supplier 2’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike’ dhe ‘Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 258 datë 21.12.2021 ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Albanian Energy Supplier 2’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike’”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 257, datë 21.12.2021, ka vendosur të licencojë shoqërinë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke i lënë kusht asaj që të depozitojë në ERE strukturën e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të saj, në përputhje me ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

- Pas sqarimeve dhe korrespondencës përkatëse të zhvilluar mes shoqërisë dhe ERE-s, në lidhje me plotësimin e kushtit të vendosur në pikën 2 të vendimit nr. 257/2021, rezultoi se ajo e ka plotësuar tashmë këtë kusht.

- Duke qenë se është plotësuar kushti i vetëm i vendimit nr. 257/2021, nuk gjen më zbatim as pika 3, që ka të bëjë me të drejtën e ERE-s për rishikimin e këtij vendimi.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 2 dhe pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 257, datë 21.12.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Albanian Energy Supplier 2’ sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

